



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P 634/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-20029-07-10-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot – Pasarele (loti 1)”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 03.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë.

Ankimues:

“B-93” shpk
Lagjia “8 shkurti”, Rr: “Andon Joro”, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Tepelenë
“Sheshi Lord Bajron”, Tepelenë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.914 datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për Miratimin e Rregullores “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se operatori ekonomik ankimues ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili nuk e ka pranuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datë 17.04.2017 është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-05987-04-13-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot –Pasarele”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë.

II.2. Në datën 19.04.2017 operatori ekonomik “Cobial” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Në datë 16.06.2017, me anë të vendimit 425/2017, Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Cobial” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-05987-04-13-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot –Pasarele”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 15.05.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë.
 2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Cobial” shpk.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë”.

II.4. Më datë 11.07.2017 Autoriteti Kontraktor ka rishpallur procedurën “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-20029-07-10-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot –Pasarele (loti 1)”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 03.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë; duke pasqyruar në dokumentat e tenderit dhe konstatimet e vendimit të KPP 425/2017, datë 16.06.2017.

II.5. Në datën 17.07.2017 operatori ekonomik “B-93” shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit me argumentat si më poshtë:

“Sipas DST pervec kriterëve diskriminuese ka edhe gabime nga AK te cilat krijojne konfuzion ndajoperatoreve te interesuar, si me poshte vijon:

1. Sipas DST "Njoftimi i kontrates per t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do te publikohet ne Buletinin e Njoftimeve Publike":

6- Afati kohor per dorezimin e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje:

Data: 14/07/2017 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

7- Afati kohor per hapjen e ofertave ose kerkesave per pjesemarrje:

Data: 14/07/2017 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

Eshte lene vetem 3 dite afat, nga 7 qe eshte e sanksionuar me legjislacionin e kerkuar (faqja 7 e DST). Kerkojme ndryshimin e ketij kriteri.

2. Eshte kerkuar ne DST:

II. UDHEZIME PEROPERATORET EKONOMIKE

Seksioni 1. Hartimi i ofertes

1.3 Do të organizohet një vizitë në kantiere në 04.07.2016 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familjarizohen me kushtet lokale.

Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këto vizite. Gjatë vizitës do t'u japin informacione shtesë e shpjegime dhe të cilat do t'u shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomikë. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantiere duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantiereve, nëse një gjë e tillë është e mundur. Mosparaqitja është kusht skualifikimi për çdo operator.

Argumentojme:

Data e vizitës në kantiere është lënë më 04.07.2017, ndërkohë që tenderi është publikuar më datë 11.07.2017. Kërkojmë që të ndryshohet ky kriter dhe të shtohet edhe orari dhe vendi i vizitës.

3. Është kërkuar në DST:

Shtojca 10 2. KRITERET E VEC'ANTA TË KUALIFIKIMIT

I 5. Operatori ekonomik të paraqesë një vertetim, të leshuar nga Autoriteti Kontraktor në të cilin të percaktohet se nuk ka detyrime ndaj Autoritetit Kontraktor. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vertetimin përkatës).

II 6. Operatori ekonomik të paraqesë vertetim nga Inspektori Mbrojtjes Territoriale Bashkia Tepelene për masë penalteti. (Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomike, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vertetimin përkatës).

Argumentojme:

Është vendosur si kriter vertetim të ndryshme nga i njëjti institucion. Për Inspektorati i Mbrojtjes së territorit Tepelene, nëse ka penalizuar ndonjë shoqëri apo subjekt, është i detyruar me ligj që ta regjistrojë këtë masë penalteti në zyren e Tatim-taksave të Bashkisë.

Për kërkesa për të paraqitur vertetim për penaltete nga IMT Tepelene është burokratike dhe e tepër prandaj kërkojmë heqjen e këtij kriteri 11.6.

Përveç arsyes së mirëargumentuar sa më sipër, kërkojmë gjithashtu heqjen e këtij kriteri pasi cenon parimin e fshehtësisë së procesit duke i'a humbur transparencën sepse me anë të kërkesës për vertetimin e kërkuar nga AK zbulohen lehtësisht pjesëmarrësit e mundshëm si operatorë ekonomikë të interesuar.

Për më tepër edhe në vendimmarrjet e mëparshme të KPP-së në rastet e mosparaqitjes së këtyre vertetimeve janë rrezuar kërkesat e autoriteteve kontraktore për një vertetim të tillë pasi në rastin kur një operator ekonomik nuk është i regjistruar pranë QKR për ushtrim aktiviteti pranë territorit administrativ ku zhvillohet procedura e prokurimit atëherë nuk i lind detyrimi për taksat vendore apo ndonjë lloj tjetër takse.

4. Eshte kerkuar ne DST:

Kapaciteti teknik:

2.3 Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Per punime te pergjithshme te ndertimit ,

NP 1- A : Punime germimi ne toke

NP2-B Ndertim civil dhe industrial

NP4- C: Rruge, autostrada, mbikalim, hekurudha trambvai, metro

NP5- A Punime nentokesore, ura vepra arti

NP7-A Ujesjellsa, gazsjellsa, vaj sjellsa, vepra kullimi e vaditje

NP 12- A Punime te inxhinierise se mjedisit

Per punimet speciale te ndertimit

N.S.1-A: Punime per prishjen e ndertimeve

A. Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifiniture me material druri, plastik ,metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese.

N.s.6-A: Sinjalistike rrugore jo ndricuese

N.S. 7-A: Barriera dhe mbrojte rrugore

N.S.8-A: Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

N.S.18-A: Punime topogjeodezike

N.S.19-A: Sistemet kunder zhurmes per infrastrukture

N.S.20-A: Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.

Per Operatoren e huaj te behet njehsimi i licences profesionale qe disponojne nga vendi i origjines prane Ministrise se Transportit dhe Infrastruktures (Ish Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit), ne plotesim te licencave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontrates.

Bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.42 date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi ", i ndryshuar; Projekt- Preventivit te objektit qe prokurohet;

Argumentojme:

Kerkojme heqjen dhe ndryshimin e ketyre kritereve:

• Heqjen e pikes:

NP2-B Ndertim civil dhe industrial

Objekti i prokurimit eshte rruge dhe jo ndertim civil (godina banimi dhe sherbime etj), apo indusrtial (objekte, godina prodhuese).

- *Ndryshimin e pikes nga niveli "C" ne nivelin "B" :*

NP4- C: Rruge, autostrada, mbikalim, hekurudha trambvai, metro.

Objekti i prokurimit ka vleren 46.796.083 Ieke nderkohe referuar vlerave te punimeve te licences se zbatimit te shoqerive perkon me piken B e cila ka vleren e punimeve 21 - 50 milion Ieke.

Nderkohe per piken C i perkasin punime nga 51 000 000 leke - 100 000 000 leke, ku ne rastin tone te prokurimit pika C nuk gjen zbatim si kerkese pasi eshte jashte objektit te vleres limit.

- *Heqjen e pikes:*

NP7-A Ujesjellsa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje.

Ne dokumentet e ngarkuara per tenderim ne sistemin elektronik, nuk ka asnje ze ne preventiv apo ne projekt per keto punime!

- *Heqjen e pikes:*

N.S.8-A: Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.

Ne dokumentet e ngarkuara per tenderim ne sistemin elektronik, nuk ka asnje ze ne preventiv apo ne projekt per keto punime! Punimet e beton-arme referuar projekt-preventivit te zbatimit jane beton arme monolite e jo te parafabriuara. Te parafabriuara konsiderohen bordurat e trotuareve te cilat nuk jane te armuara. Pra punime beton-arme parafabrikat eshte i pakuptimte.

- *Heqjen e pikes:*

N.S.19-A: Sistemt kunder zhurmes per infrastrukture

Ne dokumentet e ngarkuara per tenderim ne sistemin elektronik, nuk ka asnje ze ne preventiv apo ne projekt per keto punime! Theksojme ne kete kategori perfshihen mbjellja e pemeve etj etj.

- *Heqjen e pikes:*

N.S.20-A: Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje.

Ne dokumentet e ngarkuara per tenderim ne sistemin elektronik, nuk ka asnje ze ne preventiv apo ne projekt per punime shpimi dhe nxjerje uji apo studimore! Shpimet gjeologo-inxhinierike referuar legjislacionit jane pika qe kane te bejne me shpime per pilota, ankerat, palankola puse nafte etj etj. Eshte kriter i pakuptimte ndaj duhet hequr.

5. Eshte kerkuar ne DST:

2.4 Operatori ekonomik, duhet te kete nje punesim mesatar prej jo me pak se 70 punonjesisht te siguruar, per periudhen Janar 2016- Maj 2017 ,

Referuar ankeses tone date 20.04.2017 te bere ne rruge elektronike ne institucionin tuaj, per te cilen nuk kemi marre asnje pergjigje pra nuk eshte marre ne konsiderate nga ana juaj (ku edhe pas ankimit te nje operatori tjeter, perseri ju nuk e moret ne konsiderate dhe si rrjedhoje e ankimit ne KPP u vendos te ndryshohej numri 100 punetore i vendosur apriori nga AK-ja), ne analizen tone si shoqeri ndertimi me pervoje ne treg, na rezultojne nje numer punonjesish teper i ndryshem nga sa ju keni vendosur.

Kerkojme modifikimin e ketij kriteri, pasi referuar DST, punimet per kete objekt jane parashikuar sipas njesise se prokurimit per nje periudhe 90 ditore dhe bazuar ne manualin e cmimeve te ndertimit ne fuqi VKM Nr.629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre", kemi bere zberthimin dhe analizimin e gjithe zerave te punimeve te projekt-preventivit dhe na rezulton qe keto punime (per nje afat 90 ditor ku perfshihen edhe makinerite), kryhen me nje staf prej 13 punonjesish dhe specialistesh ne total pa perfshire stafin menaxherial dhe teknik te shoqerise. Duke qene se numri i punonjesve i kerkuar prej jush (70 punetoresh) i tejkalon standartet e vendosura nga Keshilli i Ministrave me disa here.

Bashkelidhur ju paqagesim analizen tone bazuar ne vkm e sipercituar.

6. Eshte kerkuar ne DST:

2.7 Operatori ekonomik duhet te kete ne stafin e tij edhe 1 inxhinier ndertimi, si inxhinier strukturist, te perfshire ne listepagese, per te cilin te paraqitet kontrata e punes, diploma perkatese, libreza e punes, CV, dhe deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (IQT).

Argumentojme:

Kerkojme heqjen e ketij kriteri, referuar legjislacionit te mesiperm, per pajisje me licence profesionale zbatimi dhe dhenien e kategorive te punimeve te zbatimit, Ministria e linjes (Ministria e Infrastruktures dhe Transportit) e ka pajisur subjektin zbatues (Operatorin Ekonomik) me kategorine dhe licencen perkatese. Pra meqenese firma zbatuese eshte e licencuar per keto punime, eshte diskriminuese dhe antiligjore te kerkosh kriteret e cilat jane ne kundërshtim me standartet shteterore.

Inxhinieri Strukturist eshte i domosdoshem ne projektim pra ne studimin dhe hartimin e projektit dhe nuk eshte kusht i domosdoshem per ne zbatimin e projektit. Prandaj dhe ne Fakultetin e Inxhinierise se Ndertimit ekziston profili apo titulli i diplomes "Inxhinier i pergjithshem zbatimi".

Gjithashtu, po t'i referohemi Vendimin nr.759, date 12.11.2014, te Keshillit te Ministrave, "Per licencimin profesional te individeve dhe personave juridike qe do te ushtrojne veprimtari ne fushen e studimit e te projektimit ne ndertim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim" te ndryshuar me VKM nr. 943, date 28.12.2016, duket qarte se profili

inxhinier strukturist, eshte profesion i domosdoshem ne studim-projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim individuale apo i shoqerive.

7. Eshte kerkuar ne DST:

2.13 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese mjetet dhe pajisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion Operatorit Ekonomik.

Si dhe te paraqiten mjete dhe pajisje te mbrojtjes ne pune te punetoreve, personelit si me poshte :

Kokore minimumi 70 cope

prozhektore ndricimi naten minimumi 4 cope

Komplet i ndihmes se shpejte minimumi 6 cope

Tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt minimumi 19 cope

Kemi kerkuar sqarime nga AK se ku jane bazuar per sasine e kokoreve, prozhektoreve, tabelave!

Psh: perse jane vendosur si kriter 19 tabela e jo 20?!

Ne te kundert, sasite te ndryshohen dhe te vendosen bazuar ne standartet ligjore apo KTZ.

8. Eshte kerkuar ne DST:

2.19 Operatoren e huaj ekonomik, duhet te paraqesin te gjithë dokumentacionin e tyre ne gjuhen shqipe (si gjuhe e ofertes), te bejne noterizimet perkatese brenda 3 muajve nga data e hapjes se ofertes si dhe te jene te certifikuara. Ofertuesi i huaj duhet te beje njehsimin e licensave profesionale te leshuara nga vendi i origjines, per kategorite e punimeve, prane Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit , ne Republiken e Shqiperise (mosparaqitja e saj eshte kusht skualifikues).

Megjese eshte kriter skualifikues, kerkojme te ndryshohet ky kriter sepse eshte i pakuptimte ne rastin e prokurimit te ketij objekti, pra, kur objekti i prokurimit duhet te perfundoje per 3 muaj, OE te huaj akoma nuk kane bere perkthimet dhe si mundet qe KVO e cila mund te mos jete e certifikuar per perkthimin ligjor te dokumentacionit, te beje vleresimin?!

8.1 Gjithashtu te ndryshohet dhe emertimi i ministrise:

Nga

"prane Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit", ne Republiken e Shqiperise ne: "prane Ministrise se Infrastruktures dhe Transporte".

9.. Eshte kerkuar ne DST ne piken 2.11:

Teknik ndertim 3 (tre)

Kerkojme uljen e numrit te teknikve nga 3 ne 1 te tille dhe kerkojme sqarime nga AK qe perse vetem ne AK Tepelene kerkohen 3 teknik per nje rruge me pak se 1.5 km te gjate, fenomen ky I cili nuk ka ndodhur ne 15 vitet e fundit te prokurimeve publike, nderkohe qe jane kerkuar inxhinier ndertimi profili infrastrukture, ing ndertimi profili strukturist dhe gjithashtu inxhinieri te tjere mekanike, gjeolog, gjeodet.

9.1 Kerkojme gjithashtu sqarime perse duhet inxhinieri gjeolog per kete kontrate kur ne preventivin e publikuar per kete kontrate nuk kemi te bejme me punime gjeologjike.

Ne dokumentet e ngarkuara per tenderim ne sistemin elektronik, nuk ka asnje ze ne preventiv apo ne projekt per punime shpimi dhe nxjerje uji apo studimore!

Shpimet gjeologo-inxhinierike referuar legjislacionit jane pika qe kane te bejne me shpime per pilota, ankerat, palankola puse nafte etj. Eshte kriter i pakuptimte ndaj duhet hequr.

Kerkojme heqjen e kerkeses per inxhinierit gjeolog.

Ju kujtojme se Referuar VKM-se nr. 914, date 29.12.2014 "PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK "Neni 26 Pika 5 thuhet shprehimisht: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifik ne perputhje me nenin 46 te LPP. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktojte dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve".

-Per sa me siper kerkojme modifikimin e kriterëve te kerkuara nga ana jone.

10. Eshte kerkuar ne DST ne piken 2.6:

Operatori ekonomik duhet te disponoje certifikatat e meposhtme: "Per sistemin e menaxhimit te energjise ISO 50001 : 2011, te vlefshme.

Ju rikujtojme edhe njehere se Referuar VKM-se nr. 914, date 29.12.2014 "PER MIRATIMIN E RREGULLAVE TE PROKURIMIT PUBLIK "Neni 26 Pika 5 thuhet shprehimisht: "Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfshijne te gjitha kriteret specifik ne perputhje me nenin 46 te LPP. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktojte dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve".

Ne kete rast njesia e prokurimit ka kerkuar qe OE te plotesojne nje kerkese te pabazuar ne asnje ligj dhe jo ne perputhje me natyren e objektit, pasi kemi te bejme me nje kerkese per te paraqitur cerifikate per sistemin e menaxhimit te energjise.

Objekti qe prokurohet eshte" rikonstruksion rruge" dhe kjo kerkese nuk eshte ne perputhje me objektin e prokurimit. Kerkojme heqjen e ketij kriteri.

11. Eshte kerkuar ne DST ne piken:

2.12 Operatori ekonomik duhet te duhet te kete ne stafm e tij, te perfshire ne listepagese, punonjes te kualifikuar, per realizimin e punimeve me mjete te ndryshme. Per kete duhet te kete ne stafin e tij te pakten 7 shofere dhe 7 manvratore.

Agrumentojme si me poshte:

Per pjesen qe punonjesit te jene te pasqyruar ne listepagesa Komisioni i Prokurimit Publik eshte shrehur ne vendimin nr.592/2016 se:

Sa i perket kerkeses se autoritetit kontraktor qe stafi i punonjesve te jete i pasqyruar ne listepagesa, kjo kerkese kufizon numrin e shoqerive pjesemarrese qe nuk zoterojne staf teknik te perhershem (gje qe reflektohet ne listepagesat e shoqerise), por qe kane mundesine t'a sigurojne kete staf, duke lidhur kontrata pune me afat sa afati i kontrates objekt prokurimi.

Ne lidhje me kriterin qe OE te kete ne stafin e tij te pakten 7 shofere dhe 7 manvratore, kerkojme modifikimin e ketij kriteri pasi 7 shofere dhe 7 manvratore jane shume dhe nuk jane ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates dhe volumet e puneve ne preventiv.

11.1 Gjithashtu jane kerkuar shume mjete germimi ne menyre diskriminuese dhe do te kerkonim dhe uljen e numrit te makinerive dhe njekohesisht dhe uljen e numrit te shofereve dhe manvratoreve, pasi vetem mjete germimi jane kerkuar 4 cope, nderkohe qe 1 eskavator realizon 72.7m³ ne dite (8 ORE PUNE) dhe bazuar ne afatin kohor dhe grafikun punimeve qe eshte 90 dite keto 4 mjete germimi bazuar ne manualin e ndertimit ne fuqi Vendim I KM nr. 629, date 15.7.2015 "Per miratimine manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre", kerkesat e AK per numrin e makinerive jane te ekzagjeruara.

Sa me siper kerkojme uljen e mjeteve te germimit nga 4 ne 1, njekohesisht me uljen e nr te tyre kerkojme gjithashtu edhe uljen e nr te shofereve dhe manvratoreve .

12. Kerkojme modifikimin e pikes 2.13 per disponimin e mjeteve, konkretisht :

" Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes te pakten 25 ton " 4 cope

Kerkojme uljen e numrit te kamioneve nga 4 ne 2 , dhe modifikimin e kapacitet mbajtes nga 25 ton ne me pak bazuar ne ligjislacionin e Kodit Rrugor .

Percaktimi i numrit dhe kapacitetit te kamioneve ne DST e publikuara nga njesia e prokurimit Bashkia Tepelene eshte i pa mbeshtetur ne ligj.

Per kete arsye ne kerkojme heqjen e kufizimit te kapacitetit mbajtes se kamioneve dhe kerkojme te specifikohet numri i akseve te mjeteve te transportit bazuar dhe ne ligjin per Kodin Rrugor ne fuqi, pasi ne rastin kur mjete e transportit jane me kapacitet mbajtes mbi 25 ton rezulton te jene

me shume akse, cka e ben te pamundur teknikisht manovrimin e tyre neper rruget e ngushta te fshatit Dragot .

12.1 Gjithashtu kerkojme modifikim per numrin e autobetoniereve te behet nga 2 ne 1, pasi sasia e parashikuar ne preventiv eshte e realizueshme nga nje makineri e tille dhe ky eshte kriter diskriminues dhe jo ne perpjestim me permasat dhe volumet e kontrates.

12.2 Gjithashtu kerkojme edhe modifikimin per mjetin tjetër, Freze asfalti me zinxhir me gjeresi 1.5 m.

Sqarojme se sa i perket metrave te frezes se asfaltit 1.5 m kerkojme te hiqet "kriteri i metrave" pasi kufizon pjesmarjen e OE te interesuar dhe te lihet vetm "makineri freze" e cila sherben per te njejtin qellim(frezimin).

13. AK ka kerkuar ne piken 2.13:

Linje prodhim prajmeri- 1 cope

Linje prodhim inertesh -1 cope

Impiant i prodhimit te bitumeve – 1 cope

Gjithashtu ne piken 2.15, eshte kerkuar: “ Fabrika e asfaltobetonit kur është ne pronesi duhet te shoqerohet me me dokumentin që vërteton pronesinë e saj, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B, planvendosja dhe raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshëm”.

Kerkojme sqarime ne lidhje me kerkesen "konformitetin e makinerise" qe kerkon AK , cfare nenkupton kjo dhe cilat jane organet qe e leshojne kete sipas AK .

Do te donim te kuptonim sadopak informacion dhe "dije" nga stafi i njesise se prokurimit i cili ka hartuar kriteret e DST e Autoritetit Kontraktor Bashkia Tepelene, te "iluminoheshim" ne lidhje me keto lloj teknologjish te ndryshme "konformiteti" qe do te aplikohen per kete objekt prokurimi "rikonstruksion rruge fshati ".

Ju bejme me dije se ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi certifikimet dhe lejet e nevojshme per nje linje prodhimi (cfaredolloj linje) jane lejet mjedisore QKL perkatese dhe ndonje certifikate ISO.

Kerkojme heqjen e kriterit "raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshem".

Se fundmi KERKOJME;

1. Pezullimin e procedures deri ne marrjen e vendimit nga KPP.

2. *Shqyrtimin e pretendimeve tona duke vendosur pranim te ankeses sone dhe modifikimin e kriterëve te DST”.*

II.6. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. prot.912/1, datë 18.07.2017 i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk në lidhje me pretendimet e ngritura prej tij duke deklaruar mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 27.07.2017 operatori ekonomik “B-93” sh.k, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në të cilën paraqet të njëjtat pretendime sikurse edhe në autoriteti kontraktor.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 912/11 prot., datë 01.08.2017, protokolluar me tonën me nr. 1336/2, datë 03.08.2017 me objekt “*Informacion*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "B-93 " shpk për modifikimin e kriterit të “*afatit kohor të dorëzimit të ofertave*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Seksioni 4 “*Procedura*”, në pikën 4.3 dhe 4.4 të saj nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si më poshtë vijon:

“4.3 *Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:*

Data: 03/08/2017 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

Vendi:___ www.app.gov.al

Kur oferta kërkohet të paraqitet me mjete elektronike operatorët ekonomike duhet të dorëzojnë ofertën në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, www.app.gov.al”.

4.4 *Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:*

Data: 03/08/2017 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00

Vendi: _ www.app.gov.al, Bashkia Tepelene

Ndërkohë të “Njoftimi i kontrates për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike”, në pikën 6, dhe 7 të saj, është përcaktuar se:

“6- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 14/07/2017 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00”.

7- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:

Data: 14/07/2017 (dd/mm/vvvv) Ora: 10:00”.

III.1.2. Në Udhëzimin nr. 07 datë 22.05.2015 “Për veprimet e Njesisë së Prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik” citohet se :

[...]

Sqarojmë se, “Data e publikimit të njoftimit” e zgjedhur në këtë dritare do të jetë data e shpalljes së njoftimit të kontratës në sistemin e prokurimit elektronik në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Kjo datë do të shërbejë edhe për llogaritjen e afatit të fundit për pranimin e dokumentave. Mospërlllogaritja mbi këtë bazë e afateve të publikimit, ngarkon me përgjegjësi zyrtarin e autorizuar”.

III.1.3. Në nenin 43, pika 1, pika 5, dhe pika 8 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” citohet:

[...]

Autoriteti kontraktor, për përcaktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, duhet të mbajë parasysh kompleksitetin e kontratës dhe kohën e kërkuar për hartimin e ofertave, pa cenuar kufijtë kohorë minimalë, të përcaktuar në këtë nen dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Afatet kohore në këtë ligj jepen në ditë kalendarike, me përjashtim të rasteve kur ka specifikime të tjera.

Në procedurën e hapur, me vlerë ndërmjet kufirit të lartë e të ulët monetar, afati kohor minimal për marrjen e ofertave është 30 ditë nga dita kur është shpallur njoftimi i kontratës në faqe internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Kur njoftimet janë hartuar dhe publikuar me mjete elektronike, në përputhje me formatin dhe procedurat për transmetim, të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik, afatet kohore për marrjen e ofertave, të parashikuara në pikat 2 e 5 të këtij neni, për procedura të hapura, mund të shkurtohen 7 ditë, ndërsa afatet kohore për marrjen e kërkesës për pjesëmarrje, të parashikuara në shkronjat "a" e "b" të pikës 3 dhe në shkronjat "a" e "b" të pikës 6 dhe të pikës 6/1105 të këtij neni, për procedurat e kufizuara, shërbim konsulence, konkurs projektimi106 dhe me negociim, mund të shkurtohen 5ditë”.

III.1.4. Referuar bazes ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të respektojë një minimum prej 23 ditësh për marrjen e ofertave nga momenti i publikimit të njoftimit të kontratës.

Nga verifikimi në sistemin elektronik të prokurimeve, rezulton se data e publikimit të procedurës së prokurimit është 11.07.2017, ndërkohë data e përcaktuar nga autoriteti kontraktor për dorëzimin e ofertave në pikën 4.3 dhe 4.4 të Seksionit 4 “Procedura”, është 03.08.2017, ndërsa në pikën 6 dhe 7 të “Njoftimi i kontrates për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike” është 14.07.2017.

Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se afatet kohore për dorëzimin e ofertave nga operatorët ekonomikë, i përcaktuar në pikën 6 dhe 7 të Seksionit 4 “Procedura” nuk është mbi 23 ditë, ndërsa afati i përcaktuar në pikën 4.3 dhe 4.4 të “Njoftimi i kontrates për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor , i cili do të publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike” është është mbi 23 (njëzete e tre) ditë, afat minimal ky i përcaktuar në legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor duhet të marrë masat për të saktësuar afatin; duke vendosur datën 03.08.2017 në të dy seksionet e lartpërmendura, në mënyrë që të shmangë konfuzionin tek operatorët ekonomikë ofertues në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “*kërkojmë modifikimin e dates se vizites ne kantier, eshte lene me 04.07.2017, nderkohe qe tenderi eshte publikuar me date 11.07.2017*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentet e tenderit, kapitulli II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni “Hartimi i ofertës”, pika 1.3, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si më poshtë vijon:

“1.3 Do të organizohet një vizitë në kantier në 04.07.2016 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t’u jepen informacione shtesë e shpjegime dhe të cilat do tu shpërndahen të gjithë Operatorëve Ekonomikë. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t’a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Mosparaqitja është kusht skualifikimi per cdo operator” .

III.2.2. Referuar mospërputhjes kalendarike mes datës së vizitës në kantier dhe datës së dorëzimit të ofertave; Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti duhet të marrë masat për të vendosur informacionin e saktë në lidhje me orën dhe datën e zhvillimit të vizitës në kantier-datë e cila duhet të jetë në radhë kalendarike pas datës së dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor të marrë masat për të kryer korrigjimin e konstatimit të mësipërm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “B-93” shpk se “*duhet të hiqet kriteri që operatori ekonomik te paraqese vertetim nga Inspektori Mbrojtjes Territorit Bashkia Tepelene per*

masa penaliteti.”, Komisioni vëren se:

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë”, pika 6, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si më poshtë vijon:

“6. Operatori ekonomik te paraqese vertetim nga Inspektori Mbrojtjes Territorit Bashkia Tepelene per masa penaliteti . (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqese vertetimin perkates)”.

III.3.2. Në nenin 20 “Mosdiskriminimi” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se”

“Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre”.

III.3.3. Në nenin 46 pika 1 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese”.

3. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.

III.3.4. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.3.5. Komisioni gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kërkesa e përcaktuar nga autoriteti kontraktor se *“Operatori ekonomik te paraqese vertetim nga Inspektori Mbrojtjes Territorit Bashkia Tepelene per masa penaliteti”*, është një kriter i vendosur në tejkallim të kontraës objekt

prokurimi, duke kërkuar dokumente që janë përtej objektit të kontratës dhe që kufizojnë gjithashtu konkurrencën, duke lejuar vetëm një numër të kufizuar shoqërisht të jenë pjesëmarrëse - pra vetëm ato shoqëri që ushtrojnë aktivitet në qytetin e Tepelenës (sipas ekstraktit të QKR-së), në kundërshtim me nenet 1, 2, 46/3, të LPP-së dhe rregullat e prokurimit publik. Në mënyrë që të stimulohet gjithëpërfshirja dhe konkurrenca mbështetur edhe në frymën e Ligjit të Prokurimit Publik, kriteri i sipërcituar do të konsiderohej i përmbushur, nëse nuk do të ekzistonte ky kufizim.

Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masat, për të hequr kriterin në fjalë.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “B-93” sh.p.k qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “B-93” shpk se *“kërkojmë modifikimin dhe heqjen e kategorive të disa prej licencave të përcaktuara në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.4.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3 *“Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës”, është kërkuar si më poshtë vijon:*

“3 Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Per punime të përgjithshme të ndërtimit ,

NP 1- A : Punime germimi në tokë

NP2-B Ndërtim civil dhe industrial

NP4- C: Rruge , autostrada, mbikalim, hekurudha trambvai, metro

NP5- A Punime nëntokesore, ura vepra arti

NP7-A Ujesjellsa , gazsjellsa, vaj sjellsa, vepra kullimi e vaditje

NP12- A Punime të inxhinierisë së mjedisit

Per punimet speciale të ndërtimit

N.S.1-A: Punime për prishjen e ndërtimeve

N.S.4-A: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

N.S.6-A: Sinjalistikë rrugore jo ndricuese

N.S.7-A: Barriera dhe mbrojtje rrugore

N.S.8-A: Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri

N.S.18-A: Punime topogjeodezike

N.S.19-A: Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë

N.S.20-A: Shpime gjeologo-inxhinierike , puse e shpime për ujë”.

III.4.2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” , i ndryshuar, në lidhjen 2 “Kategorizimi sipas punimeve të zbatimit të ndërtimit” dhe lidhjen 3 “Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme, përcakton në mënyrë të detajuar licencat përkatëse që nevojiten për kryerjen e secilit nga llojet e punimeve të ndërtimit.

III.4.3. Në Lidhjen 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, parashikohet:

NIVELI I SHOQËRISË	SIPAS VLERAVE NË LËKË TË PUNIMEVE TE KRYERA PËR CDO KATEGORI PUNIMI
<i>A (edhe për herë të parë)</i>	<i>0-20 milion lekë</i>
<i>B</i>	<i>21-50 milion lekë</i>
<i>C</i>	<i>51-100 milion lekë</i>
<i>D</i>	<i>101-200 milion lekë</i>
<i>E</i>	<i>201-400 milion lekë</i>
<i>F</i>	<i>401-800 milion lekë</i>
<i>G</i>	<i>mbi 800 milion lekë</i>

III.4.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihet kategoria e punimeve që kanë lidhje me kontratën objekt prokurimi.

III.4.5. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për “*modifikimin e NP4- C: Rruge, autostrada, mbikalim, hekurudha trambvai, metro, nga kategoria C në kategorinë B*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përsa i takon nivelit të klasifikimit të punimeve sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi kjo lidhet ngushtë me punimet që do të kryhen, referuar vlerës së përlllogaritur të objektit të kontratës. Duke patur parasysh se vlera e kontratës (fondi limit) e përlllogaritur nga autoriteti kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit është 46.796.083 lekë (pa TVSH), Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor, se operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin licensë profesionale të shoqërisë “*NP4- C: Rruge, autostrada, mbikalim, hekurudha trambvai, metro*”, duke dëshmuar se zotërojnë klasifikimin C; nuk përputhet me vlerën e punimeve të objektit të kontratës. Në këtë kontekst autoriteti kontraktor duhet të bëjë ndryshimet përkatëse duke modifikuar kriterin e vendosur, nga kategoria “C” në kategorinë “B”.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk qëndron.

III.4.6. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues për “*heqjen e kategorisë së licencave NP2-B Ndertim civil dhe industrial, NP7-A Ujesjellsa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje, N.S.8-A: Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri, N.S.19-A: Sistemet kunder zhurmes per infrastrukture, N.S.20-A: Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje*”, Komisioni i Prokurimit Publik, referuar Lidhjes 2 dhe 3 të VKM-së nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, si dhe natyrës së punimeve të objektit të kontratës së bashku me preventivin e punimeve të ngarkuar nga autoriteti kontraktor në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, vlerëson se nga autoriteti kontraktor janë kërkuar disa licensa të cilat nuk lidhen me objektin e kontratës objekt prokurimi dhe nuk reflektohen as në preventin e punimeve.

Përsa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor se ofruesit duhet të paraqesin licensë profesionale të shoqërisë për kategoritë “*NP7-A Ujesjellsa, gazsjellsa, vajsjellsa, vepra kullimi e vaditje, N.S.8-A N.S.19-A: Sistemet kunder zhurmes per infrastrukture, N.S.20-A: Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime per uje*”, është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që i tejkalon objektin të kontratës që prokurohet sepse është në përpjestim të zhdrejtë me volumin e saj, objektin e prokurimit dhe të zërave të punimeve të parashikuara në preventiv e për rrjedhojë kriteri për paraqitjen e këtyre licencave duhet të hiqet.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk qëndron pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “B-93” shpk se “*Kerkojme heqjen e ketij kriteri në lidhje me paraqitjen e kualifikimit te sigurimit teknik nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (IQT) për inxhinier ndertimi, si inxhinier strukturist*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.7 është kërkuar si më poshtë vijon:

“*Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij edhe 1 inxhinier ndërtimi, si inxhinier*

strukturist, të përfshirë në listëpagesë, për të cilin të paraqitet kontrata e punës, diploma përkatëse, librezë e punës, CV, dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (IQT)”.

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “ [...] *Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratë [...]”.*

III.5.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’I shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, si edhe specifikimet teknike duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në interpretimin teleologjik të nenit 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, gjykon se qëllimi i normës së mësipërme juridike lidhet me vënien në dispozicion të autoriteteve kontraktore të mekanizmave ligjor mbi vendosjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit me anë të cilave të vërtetohet se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale për të përmbushur kontratën.

III.5.4. Në Vendimin Nr. 410, datë 13.5.2015 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, tek kapitulli II “Misioni dhe funksionet e ISHTI-së”, pika 1, përcaktohet se:

“ 1. *ISHTI-ja është struktura përgjegjëse për inspektimin për zbatimin dhe përmbushjen e kërkesave ligjore dhe nënligjore në fushën e: a) përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, sipas legjislacionit përkatës; b) sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike, sipas legjislacionit përkatës; c) sigurisë së punës së instalimeve nën presion, si një linjë teknologjike e përbërë nga enë, tubacione dhe aksesore sigurie dhe që shërbejnë për mbajtjen, trajtimin dhe shpërndarjen e fluideve, sipas legjislacionit për sigurinë e enëve në presion; ç) sigurisë së punës në veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, përfshirë transmetimin, shpërndarjen, depozitimin, si dhe ndërtimin e operimin e infrastrukturës së gazit natyror, sipas legjislacionit të sektorit të gazit natyror; d) sigurisë teknike të linjave teknologjike industriale të industrisë joushqimore, brenda fushës së përgjegjësisë së ministrisë përgjegjëse për industrinë, sipas legjislacionit përkatës; dh) çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar me ligj apo akt nënligjor”.*

III.5.5. Në sa më sipër Komsioni, duke patur parsysh objektin e kontratës, preventivin e punimeve me zërat përkatës dhe profilit të inxhinierit të ndërtimit si strukturist, gjykon se kriteri i vendosur nga AK se “inxhinier ndërtimi, si inxhinier strukturist, duhet të ketë dhe dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (IQT)”, është një kërkesë që i shërben dhe është në përputhje me kontratën objekt prokurimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “B-93” shpk se “duhet ulur numri i disa prej mjeteve të kërkuara si: kokore, prozhektore ndricimi naten, komplet i ndihmes se shpejte, tabela paralajmeruese per sigurine ne objekt ; kerkojme uljen e numrit te kamioneve nga 4 ne 2; kerkojme uljen e numrit te autobetoniereve nga 2 ne 1; kerkojme te hiqet "kriteri i metrave" per mjetin tjetër, Freze asfalti me zinxhir me gjeresi 1.5 m dhe te lihet vetem "makineri freze" e cila sherben per te njejtin qellim(frezimin)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.13 është kërkuar si më poshtë vijon:

2.13 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik.

Kërkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

<i>Kamion vetshkarkues ma kapacitet mbajtës të paktën 25 ton</i>	<i>cope 4 (katër)</i>
<i>Kamion vinç</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Autopompe per hedhje betoni</i>	<i>cope 1(një)</i>
<i>Autobetoniere</i>	<i>cope 2 (dy)</i>
<i>Grejder mjet nivelues</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Fabrike asfalti</i>	<i>cope 1(një)</i>
<i>Shtruese asfalti</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Autobitumatrice</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Fshese per rruget</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Rul ngjeshes 10 - 15 ton</i>	<i>cope 1(një)</i>
<i>Rul ngjeshes 5 - 9 ton</i>	<i>cope 2 (dy)</i>

<i>Fadrome terna ose Skrep</i>	<i>cope 2 (dy)</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Freze asfalti me zinxhir me gjerësi 1.5 m</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Gjenerator 20 Kva</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Sharre per prerje asfalti</i>	<i>cope 1(një)</i>
<i>Linje prodhim prajmeri</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Linje prodhim inertesh</i>	<i>cope 1 (një)</i>
<i>Impiant i prodhimit te bitumeve specifike</i>	<i>cope 1 (një)</i>

Si dhe të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

Kokore minimumi 70 copë

Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë

Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 6 copë

Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 19 copë

Operatori Ekonomik të paraqesë deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, per makinerite dhe mjete e mesiperme.

Për mjetet që shënohen në regjistra publike, kur janë në pronësi, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikaten e kontrollit teknik, siguracion, leja e transportit nga komuna/ bashkia dhe certifikate pronesise. Të gjithë dokumentacioni duhet të jetë i vlefshëm. Per pajisjet dhe mjetet e tjera te paraqitet fature zhdoganimi ose fature tatimore e shitjes, origjinale ose kopje te noterizuar. Mjetet duhet te shoqerohen me foto.

Për mjetet dhe pajisjet me qera të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit te kontratës, shoqëruar me dokumentin që verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikaten e kontrollit teknik, siguracion, leja e transportit nga komuna/ bashkia dhe certifikate pronesise. Per pajisjet dhe mjetet e tjera te paraqitet fature zhdoganimi ose fature tatimore e shitjes, origjinale ose kopje te noterizuar. Mjetet duhet te shoqerohen me foto”.

III.6.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë

në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.6.3. Neni 26, pika 8, gërma “c”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

III.6.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

III.6.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

III.6.6. Lidhur me pretendimet e ngritura nga ankimuesi mbi disponimin e makinerive “Kokore minimumi 70 copë, Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë, Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 6 copë, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 19 copë; autobetomierë 2 copë; Kamion vetshkarkues ma kapacitet mbajtës të paktën 25 ton cope 4 (katër), ” Freze asfalti me zinxhir me gjerësi 1.5 m”; Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteri në fjalë i vendosur nga autoriteti kontraktor, është në përputhje me vlerën e konsiderueshme të fondit limit, në përpjestim të drejtë me objektin e kontratës, me numrin e

punonjësve që nevojiten për këtë procedurë prokurimi, si dhe me preventivin dhe zërat e punimeve.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “B-93” shpk se “*kërkojme të hiqet si kriter skualifikues “Operatoret e huaj ekonomik, duhet te paraqesin te gjithë dokumentacionin e tyre ne gjuhen shqipe (si gjuhe e ofertes), te bejne noterizimet perkatese brenda 3 muajve nga data e hapjes se ofertes si dhe te jene te certifikuara. Ofertuesi i huaj duhet te beje njehsimin e licensave profesionale te leshuara nga vendi i origjines, per kategorite e punimeve, prane Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit, ne Republiken e Shqipërise, si dhe te ndryshohet dhe emertimi i ministrise nga "Ministria e Puneve Publike dhe Transportit", ne "Ministria e Infrastruktures dhe Transporteve", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.7.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3, paragrafi i fundit është kërkuar si më poshtë vijon:

“Operatoret e huaj ekonomik, duhet te paraqesin te gjithë dokumentacionin e tyre ne gjuhen shqipe (si gjuhe e ofertes), te bejne noterizimet perkatese brenda 3 muajve nga data e hapjes se ofertes si dhe te jene te certifikuara. Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrise se Transportit dhe Infrastrukturës (Ish Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit), në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës”.

III.7.2. Në ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në nenin 13, pika 2 dhe nenin 41, pika 1 të tij përcaktohet se:

“Neni 13 “Agjencia e Prokurimit Publik”

2. Agjencia e Prokurimit Publik:

ç) harton dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit, sipas rregullave të prokurimit publik;

Neni 41 “Dokumentet e tenderit”

1. Autoriteti kontraktor, në hartimin e dokumenteve të tenderit, përdor dokumentet standarde, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit dhe i vë në dispozicion falas në rrugë elektronike”.

III.7.3. Në kriteret e përgjithshme të dokumentave standarde të tenderit të procedurës së hapur për punët publike, të publikuara në faqen zyrtare të APP (app.gov.al), përcatohet se : “ *Nëse gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”.*

III.7.4. Në VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92 datë 19.02.2014 “Për disa ndryshime në vendimin nr.42, datë 16.01.2008, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e rregullores për kriteret, procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, Neni 1, paragrafi i dytë, përcaktohet se:

“Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij”.

Ndërsa në KREU III “Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementet e saj, kushtet, kriteret dhe kufizime”, pika 3 “Kushtet, kriteret dhe kufizimet”, gërma “a”, paragrafi i dytë, përcaktohet se:

“Shoqëritë e huaja që aplikojnë për licencim njehsojnë licencën që disponojnë nga vendi i origjinës duke zbatuar të njëjtat procedura për kategorizimin dhe klasifikimin, si dhe shoqëritë shqiptare”.

II.7.3. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor i është referuar dokumentave standarde të tenderit dhe kuadrit ligjor në fuqi, në lidhje me hartimin e kriterit të përcaktuar në pikën III.7.1 më sipër, përse i përket dorëzimit të dokumentacionit në gjuhën shqipe, si dhe kriterit për ekuivalentimin/njehsimin në Republikën e Shqipërisë të licensave profesionale që shoqëritë e huaja kanë përfituar në vendin e origjinës.

Pra pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.7.4. Komisioni konstaton gjithashtu se autoriteti kontraktor duhet të kryejë saktësimin e emërimit të institucionit kompetent për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi; konkretisht nga "Ministria e Punëve Publike dhe Transportit", në "Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës" .

III.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “B-93” shpk se “ *Kerkesa per Inxhinier gjeolog duhet te hiqet*”; Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.8.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.5 është kërkuar si më poshtë vijon:

« 2.5. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion për stafin drejtues teknik, të përfshirë në licensë:

1 Inxhinier Ndërtimi (profil transport- infrastrukture)

1 Inxhinier Gjeodet

1 Inxhinier Mekanik

1 Inxhinier Gjeolog ».

III.8.2. Referuar VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 26 “Kontratat për punë publike”, pika 5 dhe pika 8, gërma “a” përcaktohet:

“5. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

8. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”.

Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.8.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi përcaktimin inxhinier gjellog, është një kërkesë e ekzagjeruar, në tejkallim të kontratës objekt prokurimi dhe të dispozitave ligjore përkatëse mbi prokurimet, duke patur parasysh dhe zërat e parashikuara në preventivin e punimeve dhe statusin e rrugës (rrugë ekzistuese) ku do të kryhen punimet e asfaltimit. Komisioni gjykon se kërkesa sa më sipër e autoritetit kontraktor, duhet modifikuar, duke hequr kategorinë e inxhinierit gjeolog.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk qëndron.

III.9. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “B-93” shpk se “te hiqet kriteri për paraqitjen e certifikatës ISO 5001:2011”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.9.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.6 është kërkuar si më poshtë vijon:

“2.6 Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhteme:

Sistemi i menaxhimit te cilesise EN ISO 9001:2008, te vlefshme.

Sistemi i menaxhimit te mjedisit EN ISO 14001:2004, te vlefshme.

Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurise se punonjesve ne pune OHSAS 18001:2007, te vlefshme.

Sistemi i integruar i menaxhimit PAS 99: 2012, te vlefshme.

Sistemi i menaxhimit te sigurise rrugore BS ISO 39001:2012, te vlefshme.

Per sistemin e menaxhimit te energjise ISO 50001 : 2011, te vlefshme.

Për realizimin e punimeve Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të tij”.

III.9.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

Në nenin 46 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik i ndryshuar parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”

III.9.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se:

“1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”

III.9.4. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, gëzon të drejtën për t’u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për punët që do të kryhen, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

-Certifikata ISO 50001:2011 perfaqëson standartin për menaxhimin e sistemit të energjisë dhe specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, ruajtjen dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është për të mundësuar një organizatë për të ndjekur një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumit.

III.9.5. Lidhur me kriterin e parashikuar për paraqitjen e *Certifikata ISO 50001:2011*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se vendosja e këtij kriteri është i ekzagjeruar dhe jo në përpjestim të drejtë me volumin e kontratës, objektin e prokurimit dhe të zërave të punimeve të parashikuara në preventiv. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës duhet të heqë si kriter kërkesën për paraqitjen e certifikatës *ISO 50001:2011*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk qëndron.

III.10. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “B-93” shpk se “*kërkojmë heqjen e kufizimit të kapacitetit mbajtës së kamionëve, si dhe kërkojmë të specifikohet numri i akseve të tyre*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.10.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.13 (e renditur lista e mjeteve, e listuar në pikën III.6.1 të këtij vendimi), është kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.6- Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion Operatorit Ekonomik.

III.10.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”

III.10.3. Neni 26, pika 8, gërma “c”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.10.4. Komisioni i Prokurimit Publik referuar frymës së LPP, vlerëson se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e

gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.10.5. Sa më sipër, referuar gjithashtu edhe preventivit të punimeve, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në mënyrë të arsyeshme e proporcionale ka vendosur:

- kriterin e kapacitetit mbajtës të kamionëve, në funksion të realizimit me sukses të kontratës, duke patur parasysh se autoriteti kontraktor kërkon që operatorët ekonomikë të disponojnë mjetet e nevojshme dhe të përshtatshme, duke demonstruar kapacitetet teknike për të kryer punët e kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor, në drejtim të realizimit me sukses të kontratës objekt prokurimi.

-nuk ka specifikuar numrin e akseve për kamionët- duke vendosur vetëm kapacitetin mbajtës minimal të lejuar për këto mjete; në mënyrë që të stimulohet gjithëpërfshirja dhe konkurrenca, mbështetur në frymën e Ligjit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër pretendimet e ankimesit nuk qëndrojnë.

III.11. Lidhur me pretendimin e ankimesit “B-93” shpk se “*Kerkojme heqjen e kriterit "raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshem"*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.11.1. Në shtojcën 10 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pikat 2.15, 2.16 dhe 2.17 është kërkuar si më poshtë vijon:

2.15 Fabrika e asfaltobetonit kur është ne pronesi duhet te shoqerohet me me dokumentin që vërteton pronesinë e saj, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodit III.1.B, planvendosja dhe raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentacionin e pronesise, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodit III.1.B, planvendosja dhe raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

2.16 Linja e prodhimit te prajmerit kur është ne pronesi duhet te shoqerohet me dokumentin që vërteton pronesinë e saj dhe Raportin e inspektimit per konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentacionin e pronesise, dhe raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

2.17 Linja e prodhimit te inerteve kur është ne pronesi duhet te shoqerohet me dokumentin që vërteton pronesinë e saj, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B, planvendosjen, dhe Raport inspektimi per konformitetin e makinerise, i vlefshëm.

Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentin që vërteton pronesinë e saj, lejen mjedisore leshuar nga QKL kodi III.1.B, planvendosjen, dhe Raport inspektimi per konformitetin e makinerise, i vlefshëm

Impianti i prodhimit te bitumeve specifike kur është në pronesi duhet te shoqerohet me dokumentin që vërteton pronesinë e tij, leje mjedisore kodi III.2.B, III.1.C, karten teknologjike mbi prodhimin e bitumeve specifike dhe Raport inspektimi per konformitetin e makinerise, i vlefshëm

Në rastin kur është me qera ose kontratë furnizimi të paraqitet kontrata e lidhur para noterit, e vlefshme për gjithë periudhën e realizimit të objektit, shoqëruar me gjithë dokumentacionin përkatës të qeradhënsit/furnizuesit, dokumentin që vërteton pronesinë e tij, leje mjedisore kodi III.2.B, III.1.C, karten teknologjike mbi prodhimin e bitumeve specifike dhe Raport inspektimi per konformitetin e makinerise, i vlefshëm .

Për mjetet që nuk qarkullojnë, konkretisht: shtruese asfalti, rrula ngjeshës 10-15 ton, rrulat ngjeshës 5-9 ton, Eskavatori me zinxhir, freze asfalti me zinxhir me gjerësi 1.5 m, grejder për nivelim, të paraqitet Raport inspektimi per konformitetin e makinerise, e vlefshme.”.

III.11.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese: aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin

e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.11.3. Në nenin 26 “Kontratat për punë publike” , pika 8 gërma “c” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’I vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”*

III.11.4. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “B-93” shpk se *“Kerkojme heqjen e kriterit "raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshem”*; Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar shprehimisht se cilit lloj standardi i referohet në lidhje me kriterin *"raport inspektim per konformitetin e makinerise, i vlefshem"*; duke e bërë këtë një kriter të paqartë, i cili krijon konfuzion tek operatorët ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi. Për më tepër, Komisioni gjykon se kriteri *"raport inspektimin per konformitetin e makinerise, i vlefshem"*, është një kriter i cili nuk i shërben realizimit të kontratës objekt prokurimi, e për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të hequr këtë kriter.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese qëndron.

III.12. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “B-93” shpk; Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me” *uljen e numrit të punonjësve; uljen e numrit të teknikëve të ndërtimit, shoferëve, manovratorëve, uljen e numrit të mjeteve të gërmimit, uljen e tonazhit të kamionit vetshkarkues, si dhe heqjen e kriterit për inxhinierin strukturist*”, Komisioni dhe i Prokurimit Publik vëren se:

III.12.1. Komisioni gjykon se pretendimet e mësipërme të parashtruara në ankesë përbëjnë *“gjë të gjykuar”* për të cilat Komisioni është shprehur në vendimin KPP 425/2017, datë 16.06.2017 mbi bazën e ankesave të operatorit ekonomik ankimues “Cobial” shpk për procedurën në fjalë;

vendim i cili në bazë të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përkatësisht nenit 19/1, është administrativisht përfundimtar.

Në këtë kuptim, pretendimet e ngritura nga ankimuesi “B-93” shpk për modifikimin e kriterëve të lartpërmendura nuk mund të merren në shqyrtim *ipso lege*, pasi konsiderohen një çështje e shqyrtuar tashmë nga KPP, situatë kjo, analoge me çështjet që janë gjykuar njëherë nga gjykata, për të cilat zbatohet parimi i gjësë së gjykuar.

III.12.2. Komisioni thekson faktin se fuqia e “*res judicata*”(gjësë së gjykuar) mbulon jo vetëm pjesën urdhëuese të vendimit administrativ përfundimtar, por edhe rrethanat e çështjes të pranuar në shqyrtim, përfundimet dhe arsyet në të cilat është mbështetur ai vendim në pjesën arsyetuese dhe që kanë lidhje me atë që urdhëron organi administrativ në dispozitivin e vendimit të tij.

Sa më sipër arsyetuar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues “B-93” nuk legjitimohet për paraqitjen në Komisionin e Prokurimit Publik të pretendimeve të renditura në pikën III.11 më sipër, e rrjedhimisht pretendimet në fjalë nuk do të merren në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “B-93” shpk për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-20029-07-10-2017, me objekt “Sistemim Asfaltim Rruga Dragot –Pasarele (loti 1)”, me fond limit 46.796.083 lekë pa tvsh, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 03.08.2017, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tepelenë.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “B-93” shpk.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1336 Prot; Datë 27.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

